



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.561/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Hysnije Shkodriqi, me vendbanim në Zvicër, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Hudhet i parregullt apeli A.nr.561/2021**, i datës 02.03.2021, i parashtruar nga Hysnije Shkodriqi, me vendbanim në Zvicër, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

## A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Hysnije Shkodriqi, me vendbanim në Zvicër, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 04 shkurt 2021. Në apelin e saj parashtruesja nuk ka theksuar ndonjë parregullsi por vetëm ka bashkangjitur Formularin e Aplikimit për votim nga jashtë Kosovës dhe konfirmimin e pranimin të aplikacionit nga ana e KQZ-së, dhe se të njëjtat i ka dorëzuar me zarf të mbyllur në PZAP.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së apelit gjeti se:

### **Apeli është i parregullt**

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se apeli i paraqitur nga Hysnije Shkodriqi, është i parregullt, sepse apeli në fjalë nuk i plotëson kërkesat ashtu siç parashihet me nenin 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se: *“Personi që e dorëzon apelimin duhet të përdorë formularin e gatshëm për apelim”*. Të gjitha apelimet duhet të kenë së paku informacionet vijuese:

- a) emrin, adresën dhe informacionet për kontaktim të personit që e dorëzon apelimin

- b) *arsyen për dorëzimin e apelimit*
- c) *hollësi rreth çfardo dëshmie dhe kopje të çfardo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të personit që e dorëzon apelimin apo udhëzimin se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk ajnë në posedim të parashtruesit të apelimit*
- d) *vërtetimin nga personi që e dorëzon apelimin lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së apelimit.*

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e apelit, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëcekur.

Nga arsyet e lartëcekura e në mbështetje të nenit 10.7 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.561/2021 më datën 03.03.2021.

**Kryesues i Panelit**  
**Adnan Konushevci**



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.